Asambleja e Përgjithshme e ortakëve dhe / ose organi administrativ mund të vendosë për transferimin e selisë së Shoqërisë, ose themelimin apo mbylljen e degëve dhe/ose zyrave të përfaqësimit apo zyra administrative brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe / ose jashtë saj.

FA 

Neni 3

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Kohëzgjatja e Shoqërisë fillon nga momenti i regjistrimit të saj pranë QKB për një kohëzgjatje të pacaktuar.

Shoqëria fiton personalitet juridik nga momenti i regjistrimit në QKB.

Neni 4

OBJEKTI I SHOQËRISË

Shoqëria ka për objekt, por pa u kufizuar në:

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj ekonomik në fushën e perpunimit aktiv.
- 4.2 Prodhim i veshjeve. Tregtim me shumice dhe pakice si dhe import-eksport i veshjeve, metrazheve dhe lendeve të para dhe ndihmese për prodhimin e tyre.
- 4.3 Import dhe eksport i veshjeve, shitja e këtyre produkteve në Shqipëri dhe jashtë territorit, në shtetet e tjera.
- 4.4 Kryerja e aktiviteteve të outsourcing për Shoqëri të tjera operuese në të njëjtin sektor tregtar.

Neni 5

KAPITALI I SHOQËRISË

- 5.1. Kapitali fillestar i Shoqërisë është 500 EUR (pesëqind Euro) (e barabartë me 56020 LEK me kursin e sotëm 112.04 EUR për LEK) dhe konsiston në 2 (dy) kuota të cilat zotërohen nga 2 (dy) Ortakët e Shoqërisë, të ndara në mënyrë të barabartë, përkatësisht:

-50% e kapitalit të Shoqërisë zotërohet nga Ortaku *Piero Marianelli* në vlerën 250 EUR (28010 LEK);

-50% e kapitalit të Shoqërisë zotërohet nga Ortaku *Fahmida Akhter Shikha* në vlerën 250 EUR (28010 LEK).

Kapitali fillestar i Shoqërisë mund të zmadhohet apo zvogëlohet dhe është tërësisht i likuidueshëm dhe i nënshkrueshëm.

- 5.2 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet në çdo kohë me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme e miratuar me shumicën absolute të kapitalit të shoqërisë.

Kurdoherë që një ose më shumë ortakë të heqin dorë plotësisht ose pjesërisht nga e drejta për të nënshkruar për rritjen e kapitalit përkatës ose që nuk e ushtrojnë këtë të drejtë në kushtet dhe në mënyrën e përcaktuar në rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme, zmadhimi i kapitalit të mbetur i paprekur do tu ofrohet si mundësi ortakëve të tjerë në mënyrë proporcionale me kapitalin që zotërojnë. Një zmadhim i mundshëm i kuotave të kapitalit të panënshkruar nga ortakët e tjerë do të mund tu ofrohet për të palëve të treta të interesuara, përveç kur parashikohet ndryshe nga vendimi i Asamblesë së Përgjithshme. Palët e treta të interesuara në blerjen e aksioneve në kapitalin e shoqërisë duhet të jenë me pëlqimin e ortakëve dhe për këtë arsye propozimi i tyre i blerjes duhet të jetë i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me votën pro te ortakeve qe përfaqësojnë maxhorancen absolute te kapitalit te shoqërisë. Në rast të një nënshkrimi të pjesshëm të kapitalit ajo do të konsiderohet në të gjitha rastet në rritje për pjesën e nënshkruar nga ortakët.

- 5.3. Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin pas një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të miratuar me votën pro te ortakeve qe përfaqësojnë shumicën absolute te kapitalit te shoqërisë. Në çdo rast, kapitali nuk do të reduktohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.

Zvogëlimi i kapitalit i rimbursohet secilit ortak në proporcion me pjesën e mbajtur në Shoqëri.

- 5.4. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali fillestar i saj, nga pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe nga pasuri të tjera të konsideruara ose që do të konsiderohen si të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së Shoqërisë.
- 5.5. Kuotat e kapitalit derdhen në bankë nga ortakët, në llogarinë rrjedhëse në emër të Shoqërisë.
- 5.6. Kapitali fillestar është nënshkruar tërësisht nga Ortakët e Shoqërisë.
- 5.7. Ortakët e Shoqërisë kanë të drejtën të tërheqin fondet e depozituara si kapital fillestar të Shoqërisë, në rastin në të cilin Shoqëria nuk regjistrohet në QKB brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data e depozitimit të fondit.

Neni 6

TRANSFERIMI I KUOTAVE

Transferimi i pjesëmarrjeve me akt midis të gjallëve janë subjekt i rregullave qe vijojnë.

Me "pjesëmarrje" nënkuptohet pjesëmarrja në kapitalin e shoqërisë që i takon secilit ortak, apo pjese e saj në rast të transferimit të pjesshëm dhe/ose edhe të drejta nënshkrimi që i përkasin atyre.

Me "transferim me akt midis të gjallëve" nënkuptohen të gjitha veprimet e tjetërsimit, në kuptimin me të gjere të termit, pra përtej shitjes, thjesht si shembull dhe pa e kufizuar, kontratat e shkëmbimit, dhënies dhe dhurimit.

Në të gjitha rastet kur natyra e tjetërsimit nuk parashikon një pagesë ose shpërblimi është i ndryshëm nga paratë, ortakët do të marrin pjesëmarrjen duke i paguar ofruesit shumën e përcaktuar me marrëveshje të përbashkët; në mungesë të marrëveshjes, palët mund të drejtohen arbitrit, siç specifikohet më poshtë.

Kalimi të një shoqëri fiduciare ose ri-regjistrimi nga i njëjti (me paraqitjen e mandatit të besimit) tek pronarët aktual nuk i nënshtrohet dispozitave të këtij neni.

Në rastin e një transferimi të kryer pa respektuar sa vijon, blerësi nuk do të ketë të drejtë të regjistrohet në regjistrin e ortakeve, nuk do të ketë të drejtën e ushtrimit të votës dhe të të drejtave të tjera administrative dhe nuk mund të disponojë pjesëmarrjen me efekt ndaj shoqërisë.

Pjesëmarrjet janë lirisht të transferueshme midis orokëve.

Në çdo rast tjetër të transferimit të pjesëmarrjeve, ortakeve të regjistruar rregullisht në librin e ortakeve u takon e drejta e parablerjes për blerjen.

Prandaj, ortaku që ka për qëllim të shesë ose ndryshe të transferojë pjesëmarrjen e tij, duhet të njoftojë të gjithë ortakët që rezultojnë në librin e ortakeve nëpërmjet një letre rekomande me lajmërim marrje të dërguar në vendbanimin e secilit prej atyre që rezultojnë të shënuar në regjistër; komunikimi duhet të përmbajë përgjithësinë e transferuesit dhe kushtet e caktimit.

Marrësit e komunikimeve të përmendura më lart duhet të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për blerjen e pjesëmarrjes në të cilën komunikimi i referohet duke dërguar ofertuesit një deklaratë të ushtrimit të parablerjes me letër rekomande me lajmërim marrje kthimi brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e pranimit të ofertës së parablerjes.

Në hipotezën e ushtrimit të së drejtës së parablerjes nga më shumë se një ortak, ortaku do t'u ofrohet ortakeve në fjalë në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës që mbahen nga secili prej tyre.

Nëse ndonjëri nga ata që kanë të drejtën e parablerjes nuk mund ose nuk dëshiron ta ushtrojë atë, e drejta për shkak të tij rritet automatikisht dhe proporcionalisht në favor të atyre ortakeve të cilët, anasjelltas, kanë ndërmend ta marrin atë dhe nuk e kanë hequr dorë shprehimisht nga akti i ushtrimit të parablerjes që u takon atyre.

Parablerja duhet të ushtrohet për çmimin e treguar nga ofertuesi.

Nëse çmimi i kërkuar konsiderohet i tepruar nga cilido nga ortakët që ka manifestuar në afatet dhe në format mbi vullnetin për të ushtruar parapagimin, çmimi i shitjes do të përcaktohet nga palët me marrëveshje të përbashkët.

Nëse nuk arrihet marrëveshje, çmimi do të përcaktohet nga një ekspert i emëruar nga Organi i Administrimit pas miratimit nga Asambleja e Përgjithshme me votën e favorshme të shumicës së anëtarëve që përfaqësojnë shumicën absolute të kapitalit.

Nëse parablerja nuk ushtrohet në kushtet e lartpërmendura për të gjithë pjesëmarrjen e ofruar, ortaku ofruar, nëse nuk synon të pranojë ushtrimin e të drejtës së parablerjes të kufizuar në një pjesë të pjesëmarrjes, do të jetë i lirë të transferojë pjesëmarrjen e plotë tek blerësi i treguar në komunikim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e pranimit të komunikimit nga ortakët, ose, nëse pranohet ushtrimi i parablerjes për pjesë të pjesëmarrjes, mundet brenda të njëjtit afat të transferojë këtë pjesë të pjesëmarrjes tek ortaku i cili ka ushtruar të drejtën e parablerjes, në kushtet që do të pajtohen me të njëjtën.

Neni 7

FITIMET E SHOQËRISË

Fitimet e Shoqërisë i takojnë Ortakëve të Shoqërisë.

Asambleja vendos sipas ligjit për ndarjen ose ri qarkullimin e tyre, duke përcaktuar edhe mënyrat.

Neni 8

Shoqëria do të përdorë dhe disponojë pasurinë e saj të akumuluar. Ajo mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera, materiale ose jo materiale, duke përfshirë edhe të drejtën për shitjen e pasurisë së akumuluar tek të tretët. Në Republikën e Shqipërisë, Shoqëria gëzon të drejta sikundër çdo person tjetër juridik shqiptar ose i huaj, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 9

Shoqëria vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejtat e detyrimit vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët mbartin rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë, vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në të.

Neni 10

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Bëjnë pjesë në detyrat dhe kompetencat e ortakëve të mbledhur në Asamblenë e

Përgjithshme të gjitha ato që janë parashikuar e rregulluar me ligj, si dhe të listuar në këtë Statut. Ndër këto detyra përfshihen:

1. ndryshimi i aktit të themelimit statutit;
2. zmadhimi apo zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë;
3. miratimi i buxhetit vjetor, të raporteve të administrimit, të inventarit, të bilancit dhe llogarive vjetore;
4. emërimi e shkarkimi i administratorëve, qofshin ortakë ose jo, dhe përcaktimi i detyrave dhe kompetencave të tyre, duke përcaktuar se qoftë për emërimin ashtu edhe për shkarkimin nuk do të jetë e domosdoshme të jepet shprehimisht motivi;
5. miratimi i kredive dhe dhënie e garancive;
6. disbursimi i huave të ortakeve të një vlere mbi ALL 25.000.000;
7. marrja e huave për kapitalin punues të një vlere mbi ALL 25.000.000;
8. kryerja e investimeve të një vlere mbi ALL 12.000.000, nënshkrimi i kontratave pasive me ane të cilave shoqëria merr përsipër detyrime me vlera mbi ALL 6.000.000;
9. blerjen e pjesëmarrjeve, të shoqërive dhe degëve të shoqërive, dhe operacione të transformimit të shoqërive, bashkim, ndarje, përthithje;
10. vendimi lidhur me krijimin apo mbylljen e degëve, zyrave të përfaqësimit ose agjencive të Shoqërisë;
11. vendimi për riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
12. vendimi për të punësuar punëmarrës, për emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar apo të konsulentëve të tjerë, qoftë persona fizikë apo juridikë që i kushtojnë shoqërisë me shume se ALL 1.000.000 në vit;
13. vendimi për ndarjen e kotave dhe për anulimin tyre;
14. vendimi për dhënien ose revokimin e prokurave të përfaqësimit të Shoqërisë;
15. vendime për çështje të tjera të parashikuara me ligj apo nga statuti;
16. marrjen e çdo vendimi tjetër që nuk i është deleguar ndonjë organi tjetër.

Neni 11

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

- 11.1. Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit.
- 11.2. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar nga administratori drejt ortakeve edhe nëpërmjet postës elektronike, në adresat e

deklaruar shprehimisht nga ortaket. Adresat elektronike email të ortakëve regjistrohen në bazën e të dhënave të Shoqërisë nga organi administrativ.

11.3. Njoftimi për mbledhjen e asamblesë duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet t'u dërgohet të gjithëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë; në rast të urgjencës, afati prej 7 (shtatë) ditësh mund të reduktohet në 3 (tre) dite.

11.4. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas modalitetit të lartpërmendur, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë ortaket, me unanimitet, janë dakord për të marrë këto vendime, pavarësisht nga mungesa e njoftimit të rregullt.


11.5. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren në formën e vendimeve me shkrim. Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbale. Procesverbali duhet të mbajë datën, vendin, rendin e ditës, emrin e Kryetarit të mbledhjes dhe Sekretarit që mban procesverbalin, si dhe rezultati i votimit dhe duhet të nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari. Procesverbalit i bashkëlidhet lista e të pranishmëve dhe thirrja. Kryetari do të jete Administratori i Vetëm apo Kryetari i Këshillit të Administrimit. Sekretari verbalizues mund të jete edhe një person i tretë, që nuk është ortak apo punëmarrës i Shoqërisë, me kusht që të jete zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e votave që përfaqësojnë mazhorancën absolute të kapitalit të shoqërisë.

11.6. Pjesëmarrja apo votimi në Asamblenë e Përgjithshme mund të kryhet edhe nëpërmjet mjeteve elektronike. Procesverbali i vendimeve duhet t'i dorëzohet organit të administrimit, i cili e regjistron në regjistrin e vendimeve, që do të ruhet në selinë ligjore të Shoqërisë nën kujdesin e administratorit.

11.7. Asambleja e përgjithshme mund të mbledhet edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në këtë rast vendimet e asamblesë së përgjithshme të marra jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do t'i nënshtrohen procedurave të parashikuara nga ligji shqiptar për njohjen e dokumenteve të huaja në Shqipëri dhe duhet të jenë në përputhje me parashikimet e këtij statuti për sa i takon kuorumit dhe shumicës në marrjen e vendimeve.

11.8. Asambleja e Përgjithshme, përveç nëse parashihet ndryshe në këtë Statut për disa vendime specifike, vendos me votën pro të shumicës së ortakëve që përfaqësojnë mazhorancën absolute të kapitalit të shoqërisë.



NENI 12

ORGANI I ADMINISTRIMIT

Me organ administrimi nënkuptohet Administratori i Vetëm, apo Kryetari i Këshillit të Administrimit.

Shoqëria mund të administrohet, në alternativë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, me emërim:

- a) nga një Administrator i vetëm;
- b) nga një Këshill Administrimi i përbërë nga dy ose me shume anëtarë, sipas numrit të përcaktuar nga ortaket në momentin e emërimit.

Nëse emërohen dy apo me shume administratore, nënkuptohet i krijuar Këshilli i Administrimit.

Administratoret mund të jenë edhe jo ortakë.

Nëse Asambleja emëron një Këshill Administrimi, vetë këshilli do zgjedhë kryetarin në mes të anëtarëve.

Në momentin e themelimit të shoqërisë, organi administrativ përfaqësohet nga Administratori i vetëm, *Z. Piero Marianelli, shtetas Italian, lindur më datë 25/11/1946, në Pontedera (PI), Itali, mbajtës i pasaportës me nr. YB 7712769, banues në adresën House 439&440, Apt. 6B, Road 7&8, Block H, Bashundhara, Dhaka, Bangladesh, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, duke filluar nga data 19.04.2023 deri më datën 18.04.2028.*

Organi i administrimit emërohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe ushtron të gjitha veprimtaritë e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, përfaqëson Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, me përjashtim të kompetencave që vetë ligji apo Statuti ja delegon shprehimisht ortakëve.

Për çështje me rëndësi të veçantë, administratori konsultohet me ortakët dhe adopton masat e vendosura nga Asambleja e Përgjithshme me shumicat e parashikuara me ligj dhe me Statut.

Administratori emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar duke filluar nga data e emërimit, me të drejtë riemërimi në qoftë se do të emërohet sërish administrator nga Asambleja e Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme emëron dhe revokon administratorin apo administratorët në detyrë dhe mund të emërojë administratorë të tjerë me kompetenca të përcaktuara sipas parashikimeve ligjore dhe nga Statuti.

Administratori ka të drejtë të japë dorëheqjen e parakohshme, përpara mbarimit të mandatit, me njoftim drejtuar Asamblesë së Përgjithshme. Administratori që jep dorëheqjen është i detyruar të kërkojë mbledhjen e

Asamblesë për emërimin e administratorit të ri para se dorëheqja të hyjë në fuqi.


Asambleja e Përgjithshme mund të emërojë si Administrator të Vetëm apo anëtarë të Këshillit të Administrimit persona fizikë të çfarëdo kombësie dhe të jashtëm për Shoqërinë. Secili administrator mund të ushtrojë të gjitha tagrat e përfaqësimit dhe të firmës ashtu si rezultojnë në aktin e emërimit të tyre. Secili nga ato do të jetë individualisht përgjegjës për përmbushjen e funksioneve të dhëna nga ligji për organin e administrimit dhe do të komunikojë administratorëve të tjerë të emëruar eventualisht veprimet e kryera nga ai.

Neni 13

Organi i administrimit dhe anëtarët që e përbejnë, janë përgjegjës përballë shoqërisë dhe personave të trete për shkeljet e ligjit apo normave të statutit që mund të ndodhin gjatë ushtrimit të veprimtarisë, në baze të ligjit shqiptar të aplikueshëm.

Administratori/et kryen/jnë detyrat e përcaktuara nga ky Statut, nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë dhe të gjitha ato detyra të parashikuara dhe të rregulluara me ligj. Ndër këto përsihen detyrat e renditura më poshtë.

1. Të veprojnë dhe të nënshkruajnë në emër dhe për llogari të Shoqërisë, duke përfaqësuar atë.
2. Të hartojë rregulloren e brendshme të Shoqërisë dhe një plan biznesi për vitin financiar, që do të miratohet në Asamblesë të Përgjithshme.
3. Të marrë vendime lidhur me kreditë që do të merren dhe dhënien e garancive, pas aprovimit të Asamblesë së Përgjithshme.
4. Të kryejë të gjitha aktivitetet e administrimit të aktivitetit tregtar të Shoqërisë, duke aplikuar politikën tregtare, të investimit, produktive të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme dhe të kryejë gjithë veprimtaritë që i janë caktuar nga ligji apo Statuti dhe Asambleja e Përgjithshme.
5. Të kujdeset për mbajtjen e dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë me korrektësi dhe saktësi.
6. Të kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit.
7. Të përpunojë dhe paraqesë për aprovim para Asamblesë së Përgjithshme raporte mbi veprimtarinë e Shoqërisë dhe bilancin e viti financiar në mbyllje, sipas afateve të parashikuara nga ligji;
8. Të mbaje në mënyrë të rregullt dhe të përditësuar regjistrin e vendimeve të Asamblesë së Shoqërisë;
9. Të përmbushë detyrimet tatimore kundrejt shtetit dhe enteve shtetërore;



10. Të këshillohet nga konsulentë dhe eksperte për menaxhimin e problematikave operative, ligjore dhe fiskale të Shoqërisë;
11. Të mirë administrojë Shoqërinë.
12. Të lidhë marrëveshje me të tretë në kufijtë e objektit të aktivitetit të Shoqërisë dhe të kompetencave të përcaktuara nga ortakët dhe nga ky Statut.
13. Të zbatojë rregulloren e brendshme të Shoqërisë.
14. Të jetë përgjegjës për dëmet e shkaktuara Shoqërisë nga veprimet e tij.
15. Të shpërblehet për punën që kryen sipas marrëveshjes me ortakët themelues.
16. Të informohet dhe të bëjë propozime për çfarëdolloj gjëje që e vlerëson si të rëndësishme për Shoqërinë.
17. Të kryejë të gjitha veprimet financiare dhe bankare në limitet e kompetencave të dhëna nga Asambleja e Përgjithshme dhe nga Statuti.
18. Administratorët kanë të drejtë dhe detyrë të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, sipas dispozitave të përcaktuara në këtë Statut dhe nga ligji aty ku nuk parashikohet shprehimisht në Statut.

Neni 14

TË DREJTAT E SHOQËRISË

Shoqëria ka të drejtë:

1. të kryejë të gjithë veprimtaritë që përbejnë objektin e veprimtarisë së Shoqërisë;
2. të sigurojë pasurinë e vet;
3. të marrë kredi në lekë dhe në valutë nga Bankat vendase ose të huaja në bazë të rregullave ligjore;
4. të përfitojë nga favorët që i njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet, detyrime të tjera shtetërore, dhe të tjera;
5. të investojë kudo në Shqipëri apo jashtë shtetit, me të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj;
6. të punësojë punëtore, vendas ose të huaj;
7. të eksportojë lirisht valutën që ka realizuar nga fitimet e saj.

Neni 15

DETYRAT E SHOQËRISË

Shoqëria ka për detyrë:

1. të sigurojë kapitalin e shoqërisë në formën dhe kohën e duhur;

2. të japë garanci për shërbimet që kryen shoqëria;
3. të sigurojë punonjësit e saj;
4. të plotësojë detyrimet fiskale dhe sociale që ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo;
5. të pajiset me leje/autorizime të mundshme, nëse kërkohen nga ligji, për të zbatuar objektin e veprimtarisë së saj;
6. të respektojë standardet si dhe të gjitha rregullat që lidhen me veprimtarinë e saj.

Neni 16

MARRËDHËNIET EKONOMIKE -- FINANCIARE TË SHOQËRISË

E gjithë veprimtaria e shoqërisë për plotësimin e objektit të veprimtarisë së saj, pasqyrohet në bilancin ekonomik të saj.

Neni 17

Në selinë e shoqërisë mbahet dokumentacioni financiar, në bazë të cilit, brenda datës 31 mars të çdo viti nxirret bilanci vjetor i Shoqërisë.

Neni 18

Viti financiar fillon çdo vit më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

Neni 19

Shoqëria mban llogarinë e saj në Bankë. Llogaritë mbahen në Lekë dhe/ose Euro dhe pasqyrohen në librat kontabël përkatës.

Neni 20

Nga fitimet e realizuara gjatë vitit financiar, Shoqëria, pasi bën zbritjen e humbjeve të vitit të mëparshëm, lë mënjanë 5% të të ardhurave, me të cilin krijohet fondi "Rezervë e domosdoshme", derisa ky fond të arrijë masën 10% të kapitalit të shoqërisë.

Neni 21

DISPOZITA TË VEÇANTA

Shoqëria ka vulën e saj me përmasa të zakonshme, të realizuar sipas parashikimeve të ligjit në fuqi dhe mund të ketë një markë të vetën. Në rast të krijimit të një faqe

interneti, mund të deklarohet në mënyrë vullnetare në QKB.

Neni 22

SHNDËRRIMI

Shndërrimi i Shoqërisë në shoqëri të llojeve të tjera, mund të behët me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 23

PRISHJA E SHOQËRISË

Shpërbërja e shoqërisë, mund të vijë për shkaqet e parashikuara në nenin 99 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe për arsyet si më poshtë:

- kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "për regjistrimin e biznesit";
- me vendim të gjykatës;
- humbja e kapitalit të shoqërisë;

Në këto raste, ortakët e shoqërisë vendosin mbi mënyrën e likuidimit dhe caktojnë një ose me shume likuidatorë duke u përcaktuar edhe detyrat. Administratori dhe likuidatori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë së Shoqërisë deri sa ajo t'u dorëzohet personave përkatës fizike e juridike, duke likuiduar në radhë të parë detyrimet që ka shoqëria ndaj personave të tretë.

Në rast se fondet e disponueshme, rezultojnë të pa mjaftueshëm, për shlyerjen e detyrimeve të Shoqërisë, nëse nuk e kanë bërë ende, likuidatori mund t'i kërkojë ortakëve themelues të Shoqërisë që të derdhë tërësisht kuotat që u takojnë dhe të cilat nuk janë derdhur ende.

Neni 24

LIGJI I APLIKUESHËM DHE JURIDIKSIONI

Për çdo gjë që nuk është parashikuar shprehimisht në Statut, i bëhet referencë dispozitave të ligjit në fuqi.

Të gjitha konfliktet që mund të lindin midis ortakëve të Shoqërisë, midis ortakëve dhe Shoqërisë, midis Shoqërisë dhe administratorit do të nënshtrohen për zgjidhje gjykatës kompetente të Republikës së Shqipërisë në përputhje me ligjet shqiptare në fuqi.


Neni 25

Ky statut përpilohet në 2 (dy) ekzemplare në gjuhën italisht dhe shqip, të nënshkruara rregullisht nga Ortakët e Shoqërisë.

Nënshkruar në Tiranë më datë 13.01.2023

ORTAKU

Piero Marianelli



ORTAKU

Fahmida Akhter Shikha

